



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:226012

Datë: 06.08.2024

Numri i dokumentit: 06024175

2023:305210

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me pjesëmarrjen e sekretares juridike Indira Beqa, në lëndën penale ndaj të pandehurit R.D nga fsh...-Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj: PP.II.nr.1175/23 të dt.26.12.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë 31.07.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Mimoza Sylahyseni, përfaqësuesit të dëmtuarës me autorizim, F.L, dhe të pandehurit, me dt.02.08.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me dt.06.08.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri R.D nga fsh. ...-Komuna Kacanik, i lindur më dt...., nga i ati Sh... dhe e ëma H..., e gjinisë A., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i pesë fëmijëve, ka të kryer katër klasë të shkollës fillore , i pa punë , i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal:...

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 20 maj të vitit 2023 në ora 16:40, në Kaçanik, saktësisht në vendin e quajtur ‘’Te livadhet e Kaçanikut’’, Rajoni Ekonomik Pyjor-Kaçanik, Njësia menaxhuese ‘‘Bodoshnjak’’, i pandehuri me qëllim të përvetësimit të pasurisë së huaj të luajtshme e që vetit t’i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Pyjet e Kosovës nr.2003/3, në atë mënyrë që duke e përdorë një sharrë motorike, ka prerë 60 trunje të llojit ‘‘bung dhe shkozë’’, me diametër 12-15 cm, me lartësi 6-7 metra dhe vëllim të përgjithshme prej 2.34 m³, me ç’ rast Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në Kaçanik, i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 299,52 Euro,-

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-074.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,7,38,43,69,70 dhe 71 par.1 nenpar.1.3, të KPRK-se, si dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

GJYKON

Me dënim me kusht, me të cilin i vërtetohet dënimi me gjobë në shumë prej 450.00 , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën do t’i revokohet dënimi me kusht.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë pranë kësaj gjykate shumën prej 30,00 € , ndërsa ne emër të taksës për Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimit në shumë prej 20.00€, të gjitha këto paguhen pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, në afat të njejte me gjobën, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Obligohet i pandehuri, që të dëmtuarës DBZHRP Komuna Kaçanik, t’i kompenzojë dëmin në vlerë prej 299.52 €.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzen PP.II.nr.1175/23 të dt.26.12.2023, të pandehurin R.D nga fsh....-Kaçanik, e ka akuzuar për veprën penale, Vjdhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-074.

Në bazë të kesaj aktakuze, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, me dt. 31.07.2024.

Prokurorja e shtetit, Mimoza Sylja-Hyseni në fjalën e saj, me rastin e prezentimit te aktakuës , deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës se parashtruar me shkrim pranë kësaj gjykate.

Përfaqësuesi I të dëmtuarës, F. L, në fjalën e tij në shqyrtimin fillestar, I bashkangjitet ndjekjes penale dhe parashtron kërkesën pasurore juridike në vlerën si në aktakuzë.

I pandehuri ne fjalen e tij në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se, e pranon fajësinë për veprën penale, duke shtuar se drutë kishte për qëllim që t’I dërgojë vajzës së tij e cila jeton në kushte të dobëta ekonomike, megjithate pavarësisht këtyre rrethanave I njejt i thekson se e ndien veten të penduar për veprimin e tij, dhe duke I premtuar gjykatës se veprime të tilla nuk do të përsërisë në të ardhmen, njëherit edhe I kërkon gjykatës, që, duke patur parasysh se jeton vetëm nga puna që e bën si bujk, me rastin e marrjes së vendimit t’I shqiptohet një dënim sa më I ulët që të jetë e mundur.

Prokurorja e shtetit në fjalën e tij është dakorduar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke vlerësuar se pranimi I fajësisë është bërë vullnetarisht, duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 242 të KPP-së, andaj edhe I propozon gjykatës që të pranohet pranimi I fajësisë për të pandehurin dhe t’I shqiptohet sanksion penal sipas ligjit, duke patur parasysh pranimin e fajësisë si rrethanë lehtësuese ndërsa intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, si rrethanë rënduese.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 par. 1 të KPRK-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi

i fajesise është bërë vullnetarisht , se pranimi i fajit mbeshtetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike, andaj me këto gjykata vertetoi gjendjen faktike si në dispozitivin e aktakuzës.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-074.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPRK-se, kështu që si rrethane lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në tërësi në shqyrtimin fillestar, duke shprehur keqardhje dhe duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, ndërsa rrethanë të posaqme rënduese, gjykata gjeti se i njëjti, bazuar në evidencën penale, ka patur edhe raste tjera penale dhe kundërvajtëse të natyrës së njëjtë, për të cilat është gjykuar me aktgjykim të plotfuqishëm të gjykatës.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin R.D, i akuzuar për veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-074, e gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla penale dhe se me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore jurididike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK
2023:305210 datë 06.08.2024

Sekretarja Juridike
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimet. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.